

LIGJ
Nr.7380, datë 8.5.1990

**PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS POPULLORE TË
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në Kodin Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë bëhe këto ndryshime:

1. Në nenin 22, paragrafi i dytë dhe i tretë ndryshohen si vijon:

“Dënimi me vdekje nuk jepet kundër personave që në kohën e kryerjes së kriminit nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç. Si dhe kundër grave”.

2. Pas nenit 38 shtohet një kre i ri me këtë përmbajtje:

KREU I PESTË
SHUARJA E NDJEKJES PENALE DHE E DËNIMIT

Parashikimi i ndjekjes penale

Neni 39

Nuk mund të bëhen ndjekje penale, kur nga dita e kryerjes së veprës penale, gjer në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar:

- a) 20 vjet për vepra penale për të cilat ligji parashikon si lloj dënimit me vdekje.
- b) 10 vjet për vepra penale për të cilat ligji parashikon si lloj dënimi heqjen e lirisë më shumë se 5 vjet.
- c) 5 vjet për vepra penale për të cilat ligji parashikon dënimin me heqje të lirisë gjer më 5 vjet ose dënime të tjera më të lehta.

Neni 40

Kur personi që ka kryer një vepër penale i fshihet hetimit ose gjykimit pas marrjes kundër tij të masave të sigurimit, afatet e parashkrimit të ndjekjes penale të caktuara në nenin 39 të këtij Kodi dyfishohen, por nuk mund të kapërcejnë të 25 vjetët.

Kur personi që ka kryer një vepër penale, për të cilën nuk ka filluar ndjekja penale, kryen një vepër të re gjatë afatit të treguar në nenin 39 të këtij Kodi, atëherë ecja e parashkrimit për veprën e kryer më parë ndërpritet dhe afati i parashkrimit llogaritet nga data e kryerjes së veprës së re penale.

Neni 41

Parashkrimi i vendimit të dënimit

Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet, kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar:

- a) 20 vjet për dënimin me vdekje;
- b) 10 vjet për dënimin me heqje të lirisë më shumë se 5 vjet;
- c) 5 vjet për dënime me heqje lirie deri në 5 vjet ose për dënime të tjera më të lehta.

Neni 42

Për krimet kundër shtetit, në të cilat ligji parashikon si lloj dënimi atë me vdekje, nuk ka parashkrim a të ndjekjes penale, as të vendimit të dënimit.

Neni 42/a

Heqja e dënimit

Quhen të padënuar:

a) Ata që janë dënuar me kusht, kur në vazhdim të afatit të provës së caktuar nga gjykata nuk kanë kryer vepër tjetër penale.

b) Ata që janë dënuar me heqje të lirisë për një kohë gjer në 6 muaj, ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjtë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale.

c) Ata që janë dënuar me heqje të lirisë për një kohë më shumë se 6 muaj, gjer në 5 vjet dhe që gjatë 5 vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale.

Neni 42/b

Për personat e dënuar me heqje të lirisë për një kohë më shumë se 5 vjet, deri në 10 vjet dhe, kur kanë kaluar 7 vjet nga dita e vuajtjes së dënimit, si dhe për personat e dënuar me heqje të lirisë për një kohë më shumë se 10 vjet, deri në 25 vjet dhe kur kanë kaluar 10 vjet nga dita e vuajtjes së dënimit, gjykata, me kërkesën e organeve shtetërore os të organizatave shoqërore, mund ta heqë dënimin, në qoftë se gjatë kësaj kohe këta persona nuk kanë kryer vepër tjetër penale dhe tregojnë me sjelljen e tyre se janë përmirësuar.

Neni 42/c

Lirimi para kohe me kusht

Kur i dënuari me heqje të lirisë, me internim, dëbim, me riedukim nëpërmjet punës a me ndalimin e ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie të caktuar, tregon me sjelljen dhe punën e tij se është përmirësuar, me kërkesën e organeve shtetërore ose të organizatave shoqërore mund të lirohet nga gjykata para kohe me kusht, pasi të ketë vuajtur gjysmën e dënimit.

Lirimi para kohe me kusht tërhiqet nga gjykata, në qoftë se i liruari gjatë kohës së kushtit dënohet për një vepër tjetër penale po aq të rëndë ose më të rëndë se e para.

3. Në nenin 45, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Ligji i ri nuk e dënon veprën penale ose që e zbut dënimin. Ka fuqi parapavepruese”.

4. Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

Agjitacioni dhe propaganda kundër shtetit

“Agjitacioni e propaganda me gojë, me shkrim ose në forma të tjera për të përmbysur rendin shtetëror e shoqëror të vendosur në Kushtetutën e RPSSH, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet;

Propaganda luftënxitëse ose fashiste dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet”.

5. Neni 58 ndryshohet si vijon:

Veprimtaria armiqësore gjatë Luftës Nacionalçlirimtare

“Veprimtaria aktive kundër Luftës Nacionalçlirimtare e zhvilluar nga persona të ndodhur në vende me përgjegjësi në shtet ose nga persona të ndodhur në shërbime të fshehta apo në organizata tradhtarë, dënohet;

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje”.

6. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 49, 54, 55, 57, 59, 67, 76, 78, 97, 98, 124, 139, 142, 144, 147, 152, 153, 154, 155, 156, 157 dhe 159, dënim me vdekje, shfuqizohet.

7. Neni 118 ndryshohet si vijon:

Shpifja ose fyerja kundër organeve më të larta të shtetit e të Partisë

“Shpifja ose fyerja kundër organeve më të larta të shtetit e të partisë ose e përfaqësuesve të tyre dënohet:

me heqje të lirisë gjer në pesë vjet”.

8. Pas nenit 118 shtohet neni 118/a me këtë përmbajtje:

Kundërshtimi ndaj përfaqësuesit të shtetit

“Kundërshtimi me dhunë fizike ose në bashkëpunim që i bëhet përfaqësuesit të shtetit, kur është duke kryer detyrën sipas ligjit, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet”.

9. Neni 127 ndryshohet si vijon:

Kalimi i paligjshëm i kufijve të shtetit

“Kalimi i paligjshëm i kufijve të shtetit dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në pesë vjet”.

10. Nenet 40, 41, 42, 47 (shkronjat “dh” e “gj”) dhe neni 59, shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA